

Akademia për gjyqtarë dhe prokurorë publik:

Ndërtimi i kapaciteteve gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut

Statistikat kryesore

Që nga themelimi i saj, Akademia ka zbatuar tetë cikle të plota trajnimi për gjyqtarët dhe prokurorët publik të ardhshëm.

285 të diplomuar përfunduan trajnimin fillestar:

174 u emëruan si gjyqtarë

111 u emëruan si prokurorë publik

Konkurrenca më e lartë u regjistrua në ciklin e 7-të:

673 aplikantë për **58** pozicione

Programi i trajnimit fillestar

Kohëzgjatja totale:
24 muaj

9 muaj trajnim teorik

15 muaj punë praktike në gjykata dhe prokurori

Kurrikula përfshin të drejtën ndërkombëtare, etikën gjyqësore dhe module të gjera mbi të drejtat e njeriut.

Trajnime të fokusuara në të drejtat e njeriut

Akademia i vendos të drejtat e njeriut në qendër të misionit të saj:

- Modulet mbulojnë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeirut;
- Pjesëmarrësit studiojnë traktatet kryesore të OKB-së dhe simulojnë skenarë ligjorë të jetës reale;
- Vëmendje e specializuar i kushtohet të drejtave të grupeve vulnerabël: fëmijëve, personave LGBTI+, personave me aftësi të kufizuara dhe pakicave etnike.

Mbështetja e procesit të Rishikimit Periodik Universal (RPU)

Nëpërmjet bashkëpunimit me Institutin për politikë evropiane (EPI), Akademia ka integruar prioritetet e Rishikimit Periodik Universal (RPU) në trajnimin e saj:

U mbajtën dy sesione trajnimi të dedikuara për gjyqtarë dhe prokurorë publik

Njëra u përqendrua në antidiskriminim

Tjetra në dhunën me bazë gjinore

Këto aktivitete mbështesin drejtpërdrejt zbatimin e rekomandimeve të RPU-së dhe përafrjnë praktikën kombëtare me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Sfidat kryesore institucionale

Pavarësisht rolit të saj strategjik, Akademia përballlet me sfida të vazhdueshme që pengojnë shkallëzueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e programeve të saj:

- **Infrastrukturë e kufizuar** - Akademisë i mungojnë hapësira të dedikuara dhe të pajisura plotësisht;
- **Kufizime në burimet njerëzore** - nivelet e personelit mbeten të pamjaftueshme për grupe të mëdha trajnimi;
- **Boshllëqe në sistemin e IT** - mjetet dhe platformat dixhitale kanë nevojë për modernizim;
- **Mospërputhje ligjore** - mbeten boshllëqe midis ligjit vendas dhe normave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut;
- **Ngarkesa të mëdha pune** - gjyqtarët dhe prokurorët kanë kohë të kufizuar për t'u angazhuar në trajnime të vazhdueshme;
- **Rezistencë ndaj ndryshimit** - praktikat e rrënjësura mund të pengojnë reformën e orientuar drejt të drejtave të njeriut;
- **Presion në shkallëzim** - cilësia kërcënohet kur grupet e trajnimit tejkalojnë 40 pjesëmarrës.